



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE PRIVAT
ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT
"HOTI BAILIFF SERVICE" SH.P.K



Nr. 4315/19 Prot.

Durrës, më 14.05.2021

URDHËR
PËR HEQJEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE

QENDRA KOMBËTARE
E BIZNESIT
Nr. 5045 Prot.
Datë 20.5.2021

Drejtuar : Qendrës Kombëtare të Biznesit --- Tiranë.

Unë Hasan Zela përmbarues gjyqësor privat bazuar në vendimin Nr. 923 datë 24.07.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

KONSTATOVA:

Se në datë 15/12/2015 është depozituar pranë Shoqërisë përmbarimore private "Hoti Bailiff Service" shpk kërkesa e kreditorit "AMA" së bashku me vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, lëshuar për Aktin Administrativ, sanksion gjobë Nr. 18 datë 25.06.2015, lënë në fuqi me vendimin nr. 19 datë 03.09.2015, të A.M.A, me palë:

- Kreditor : Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), ish KKRT.
- Debitor : Tv Kabllor Jug (Shoqëria INTEL MEDIA me administrator Edmond Sulejmani, Nr. Nipt K82803409T)
- Objekti : Kthim Shume

Në kushtet kur pala Kreditore me shkresën nr.2731 datë 28.08.2017 ka kërkuar zgjidhjen e kontratave me shoqërinë përmbarimore Hoti bailiff Service, është proceduar me ndërprenjen e procedurave përmbarimore në zbatim të këtij titulli ekzekutiv

Sa më sipër në mbështetje të neneve 527-593 të K.Pr.Civile dhe të ligjit Nr.26/2019 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor Privat"

URDHËROJ:

- 1- Qendrën Kombëtare të Biznesit – Tiranë të heqë masën e sekuestros konservative mbi aksionet/kuotat që zotëron pala debitore **Tv Kabllor Jug** (Shoqëria INTEL MEDIA me administrator Edmond Sulejmani, Nr. Nipt K82803409T)
- 2- Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brënda afatit ligjor .
- 3- Personat që bëhen pengesë, do të përgjigjen sipas dispozitave të Kodit Penal dhe nenit 598 e në vijim të K.Pr.civile.
- 4- Ky urdhër mbahet në tri kopje, dhe u njoftohet palëve të cilat kanë të drejtën e ankimit në Gjykatë brenda 5 ditëve.

PËRMBARUES GJYQËSOR
HASAN ZELA

